



**REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVA
ZYRA E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM/KANCELARIJA GENERALNOG
REVIZORA/OFFICE OF THE AUDITOR GENERAL**

Nr. i dokumentit:22.6.3-2010-08

**RAPORT I AUDITIMIT PËR PROJEKTIN "RREGULLIMI I SHESHIT
SKENDERBEU" NË PEJË**

25 Tetor 2011

I. Hyrje

Ne kemi kryer një auditim të pasqyrës financiare të kontratës “Rregullimi i sheshit Skënderbeu” në Pejë. Marrëveshja mes UN-HABITAT dhe Komunës së Pejës, në vlerë 245,292€ është lidhur me datën 01/10/2010. Në Marrëveshje thuhet, (neni 6c) se një auditim i tillë është kusht për pagesën e kështit të fundit nga ana e UN-HABITAT-it.

Projekti është realizuar me bashkëfinancim në mes UN-HABITAT-it dhe Komunës së Pejës, ndërsa procedurat e prokurimit i ka zhvilluar komuna. Në bazë të marrëveshjes së bashkëfinancimit me komunën është paraparë që UN-HABITAT-i të marrë pjesë në këtë projekt me 50% ndërsa Komuna 50%.

Duke pasur parasysh se Komuna e Pejës këtë projekt nuk e kishte përfshirë në listën e Planit të Prokurimit për vitin 2010, kishte lidhur një marrëveshje për bashkëfinancim të këtij projekti me Ministrinë e Administrimit të Pushtit Lokal (MAPL). MAPL për projektin në fjalë i kishte ofruar 150,000€

Komuna kishte shpërblyer me kontratë Kompaninë “Vraga” nga Peja sipas ofertës ekonomikisht më të favorshme.

II. Fushëveprimi

Gjatë auditimit, ne kemi kryer ekzaminimin e këtij projekti duke filluar nga shpallja e tenderit, procesi i tenderimit dhe përzgjedhja e fituesit, deri në realizimin final të projektit. Ne gjithashtu kemi krahasuar rezultatin e projektit në lidhje me marrëveshjen mes UN-HABITAT-it dhe Komunës së Pejës, si dhe mes Komunës së Pejës me Kontraktorin.

Ky auditim filloi me datën 20/09/2011 deri me 22/09/2011 dhe është bërë me kërkesën e komunës së Pejës.

III. Të gjeturat

Auditimi ynë në bazë të testeve të kryera dhe ekzaminimit fizik të projektit ka identifikuar këto parregullsi:

1. Pasqyra financiare pasqyron pagesat e bëra gjatë projektit:

Përveç kësaj, gjatë implementimit janë vërejtur një numër të metash:

2. Komisioni përgjegjës arriti në përfundimin, më 24 qershor 2011, se puna është kryer në pajtim me kontratën. Përveç kësaj, ne kemi vërejtur mangësi në cilësi në fushat e mëposhtme:

- Punimi i pjesës me dukje si Tabela e shahut me dimensionet e caktuara ishte kryer pjesërisht. Shkrimet, numrat si dhe dy logo të UN-HABITAT nuk ishin vendosur ashtu siç ishte paraparë; dhe
 - Kualiteti i pllakave të mermerit të vendosura nuk ishin të nivelit të kënaqshëm. Ne kemi vërejtur se pllakat e mermerit ishin të plasaritura dhe jo të vendosura në një linjë.
3. Procesi i prokurimit ishte shoqëruar me një numër të metash; së pari në lidhje me fazën e dhënies së kontratës.
- Në kushtet e veçanta të kontratës ishte specifikuar në mënyrë eksplicite se: “Kontraktori është i obliguar që të ofroj garancion për punimet e kryera prej 24 muajsh pas pranimit teknik”. Ky garancion nuk ishte ofruar nga fituesi (Vraga);
 - Vraga nuk e kishte plotësuar kriterin mbi disponimin e kapacitetit teknik dhe profesional. Ky kriter ishte kërkuar në dosje të tenderit. Vragës i mungonin dëshmitë për punëtorët e regjistruar në Administratën Tatimore;
 - Vraga nuk kishte ofruar disa nga dëshmitë e kërkuara për pajisjet; siç janë librezat e qarkullimit dhe dëshmi tjera poseduese;
 - Sigurimi i tenderit të Vragës nuk e ka mbuluar në tërësi periudhën e kërkuar me dosje të tenderit. Sigurimi i tenderit është ofruar nga data 30/08/2010 deri më 24/12/2010 respektivisht në total për 117 ditë dhe jo 120 ditë siç është kërkuar;
4. Së dyti, gjatë zbatimit të punëve, të vonuara tepër, ne kemi vërejtur të meta në lidhje me pagesat:
- Ne kemi vërejtur se pozicionet e paguara janë me gabime. Në bazë të rishikimit të pagesave për situacionin e parë dhe të dytë kemi vërejtur se prej 25 pusetave të cilat janë paguar ishin pranuar si të përfunduara vetëm 22 puseta.
 - Ne kemi vërejtur se nuk janë specifikuar mënyra e pagesave sipas situacioneve. Pra, nuk është caktuar sipas përqindjeve shuma e situacioneve të cilat do duhej të paguhen; dhe
 - Peja nuk ka aplikuar penalltitë siç përcaktohet në kontratën me Vragën.
5. Për sa i përket pagesave të fundit, ne kemi vërejtur se vlera e punëve të përfunduara dhe të faturuara ishte 242,843€ apo 2,448€ më pak se punët e kontraktuara. Kjo kishte ndodhur për shkak se paralogaria dhe paramasa kanë ndryshuar pas matjeve të posaçme të kërkuara nga UN-HABITAT.

Vlera e paguar nga MAPL ishte 136,500€ ndërsa e UN-HABITATI 99,313€ Pagesa e fundit nga HABITATI në vlerë 7,030€ do të bëhet pasi që ZAP do ta jap një mendim final lidhur me projektin e realizuar.

Konkluzione

Ne arrijmë në përfundimin se rezultati financiar i këtij projekti doli të jetë më shumë i favorshëm për komunën e Pejës sesa parashihej në kontratë. Në të njëjtën kohë, nga Buxheti i Kosovës janë paguar më shumë se 50% të kostove.

Ende mbetet një numër pikëpyetjesh në lidhje me dhënien e kontratës kompanisë Vraga.

Kontrollet e brendshme të pamjaftueshme në nivelet e duhura kanë rezultuar që ky projekt të mos implementohet në pajtim të plotë me kërkesat dhe kushtet e kontratës.

Rekomandim 1

Rekomandojmë Kryetarin e Komunës që të sigurojë se :

- Zyra e Prokurimit do të analizojë shkaqet për lidhjen e kontratës me Operatorin Ekonomik, i cili nuk i kishte përmbushur kriteret e kërkuara;
- Komisioni për Vlerësim të Tenderit, në të ardhmen, vlerëson në mënyrë rigoroze të gjitha ofertat sipas kriterëve të caktuar;
- Të gjitha pllakat e mermerit do të vendosen ashtu siç kërkohet me kontratë; dhe
- Komisioni për Pranim Teknik, në të ardhmen, pranon sipas kushteve të kontratës për sa i përket si sasisë ashtu edhe cilësisë.

Rekomandimi 2

Rekomandojmë donatorin UN-HABITAT që :

- Të mos paguaj situacionin e fundit pa u siguruar se pllakat të plasaritura janë riparuar dhe se logo, numrat, dhe shkrimi janë vendosur mbi Tabelën me figurat e shahut sipas marrëveshjes; dhe
- Të marrë në konsideratë që të ketë përfaqësues në Komisionet për Vlerësimin e Tenderëve në të ardhmen.

Menaxhmentit të Komunës i është dhënë mundësia për të dhënë komentet mbi draftin e këtij raporti.

Menaxhmenti i Komunës i ka pranuar të gjeturat dhe konkluzionet e paraqitura në raportin e auditimit për projektin "Rregullimi i sheshit të Skënderbeut" në Pejë. Për më tepër, ata janë zotuar se do t'i bëjnë të gjitha përpjekjet për t'i adresuar rekomandimet e dhëna.